



REPUBLIKA E KOSOVES		REPUBLIC OF KOSOVA	
AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT AGENCIJA PROTIV KORUPCIJE ANTI-CORRUPTION AGENCY			
Dep.	2-D/DPK	Nr Prot.	01-4230/14
Dep.		Br Prot.	Prot No
Nr. i faq.	02	Data	18.11.2014
Broj stranica		Datum	Date
Nr. pages			



Republika e Kosovës Republika Kosova - Republic of Kosova

AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT
AGENCIJA PROTIV KORUPCIJE
ANTI - CORRUPTION AGENCY

Në mbështetje të nenit 11 (paragrafi 1.1), nenit 5 (paragrafi 1 pika 1.5), nenit 18 (paragrafi 10 dhe 11) të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit, si dhe nenit 19 (paragrafi 11) të Rregullores nr. 01/2014 së Punës të Agjencisë kundër Korrupsionit, Drejtori i Agjencisë kundër Korrupsionit me datë 17.11.2014, mori:

V E N D I M

I. Mbyllet rasti me nr. AKK- 03-3304/14, për z. Naser Bajraktari – Drejtor i Departamentit të Ujërave në Ministrinë e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, për shkak se nuk ka të dhëna të mjaftueshme që argumentojnë dyshimin e arsyeshëm për ekzistimin e konfliktit të interesit.

II. Rasti mund të rihapet në çdo kohë kur mund të paraqiten rrethana të reja.

A r s y e t i m

I. Rasti i rihapur nën dyshimin e bazuar për Konflikt Interesi në Ushtrimin e Funkcionit Publik, nr. AKK – 03-3304/14, për z. Naser Bajraktari – Drejtor i Departamentit të Ujërave në Ministrinë e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, është trajtuar sipas procedurës së paraparë në Ligjin Nr. 04/L-051 Për parandalimin e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksionit publik (më tutje: Ligji PKI).

Ky rast është rihapur pas pranimi të një informate se z. Bajraktari mund të gjendet në situatë të konfliktit të interesit, si zyrtar i lartë në Ministrinë e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor dhe njëkohësisht Drejtor i Bordit në Kompaninë Rajonale të Ujërave “Hidroregjioni Jugor” SH.A. Prizren.

Rasti është rihapur nën dyshimin se zyrtari i lartë nuk mund të ushtroj njëkohësisht këto dy funksione, për shkak se është e ndaluar në bazë të Ligjit për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr. 03/L-087 Për Ndërmarrjet Publike. Neni 9 i këtij ligji përcakton se një person ka të drejtë të shërbejë si drejtor vetëm nëse nuk punon në ndonjë institucion ku bëhen politikat zhvillimore për Ndërmarrje Publike përkatëse ku kandidati punon.

Për këtë arsye z. Bajraktari, fillimisht është njoftuar me shkresë zyrtare nga Agjencia kundër Korrupsionit, për fillimin e procedurës së shqyrtimit të gjendjes së konfliktit të interesit, ndërsa më pas është takuar me zyrtarët e Agjencisë për t'i sqaruar situatën në të cilën ndodhet.

Gjatë takimit është biseduar për faktet që posedon Agjencia në lidhje me këtë rast lidhur me kufizimet si Drejtor i Departamentit të Ujërave në Ministrinë e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor dhe Drejtor i Bordit në Kompaninë Rajonale të Ujërave "Hidroregjioni Jugor" SH.A. Prizren.

z. Bajraktari ka deklaruar se Ministria e Planifikimit Hapësinor nuk i bënë politikat zhvillimore për ndërmarrjen "Hidroregjioni Jugor", kjo ministri i bën vetëm politikat zhvillimore të resurseve ujore.

Këtë konstatim të zyrtarit Naser Bajraktari Agjencia e ka vërtetuar më vonë, në një takim që ka organizuar me Sekretarin e Ministrisë së Planifikimit Hapësinor. Ai ka konfirmuar se kjo ministri nuk i bënë politikat zhvillimore për Ndërmarrjen Publike "Hidroregjioni Jugor".

Prandaj, Agjencia kundër Korrupsionit, duke pasur parasysh këto fakte, vlerëson se zyrtari i lartë Naser Bajraktari mund t'i ushtroj këto funksione publike duke pasur parasysh kufizimet e nenit 15 (pika 2) të Ligjit PKI.

Mirëpo, kjo nuk e përjashton nga konflikti rast për rast i interesit në rastet e ndonjë vendimmarrje për ndonjë çështje që lidhet me këto dy funksione publike. Kjo mund të ndodhë në rastet kur zyrtari i lartë Naser Bajraktari merr ndonjë vendim, në kuadër të kompetencave që ka si drejtor në Ministrinë së Planifikimit Hapësinor, vendim i cili, do të kishte efekt juridik për Ndërmarrjen "Hidroregjioni Jugor".

Kjo përcaktohet në nenin 13 të Ligjit PKI i cili thotë:

"Çdo zyrtar i lartë gjatë ushtrimit të funksionit të tij publike, në bazë të njohurive të tij dhe në mirëbesim, detyrohet që të bëjë vet deklarimin paraprak, rast për rast, të ekzistencës së interesit të tij private lidhur me vendimmarrjen në një çështje të caktuar, që mund të bëhen shkak për lindjen e një konflikti të interesit".

II. Në pajtim me nenin 18 (paragrafi 11) të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit, Agjencia mund të rihap rastin në çdo kohë kur mund të paraqiten rrethana të reja, andaj u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Vendimi iu dërgohet:

- Zyrtarit të lartë publik;
- Drejtorit të DPK- së;
- Z./znj. (zyrtarit përgjegjës).

Drejtor i Agjencisë kundër Korrupsionit

Hasan Preteni

